



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI

VENDIM

Nr.182, Datë 10.09.2021

MBI

**PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA  
FURNIZUESI I MUNDËSISË SË FUNDIT PËR MUAJIN GUSHT 2021**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 87, pika 4, të Ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes të energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit”, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 201, datë 04.12.2017, e ndryshuar me vendimet e bordit nr. 144, datë 25.06.2018 dhe nr. 233, datë 20.12.2019; nenit 15, të Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr.96, datë 03.09.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 10.09.2021, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur me nr.118/5 prot., datë 09.09.2021, nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, “Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin Gusht 2021”,

**Konstatohet se:**

- Shoqëria Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSHU sh.a.) me shkresën e saj nr. 7654 prot., datë 03.09.2021, ka paraqitur në ERE aplikimin për miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për muajin Gusht 2021, për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV, të cilët furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit.
- Bazuar në kërkesën e FSHU sh.a., kostot administrative të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit për vitin 2021, janë vlerësuar sa ato të vitit 2020.
- **Tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit:** bazuar në vendimin nr. 212, datë 15.12.2020, “Mbi lënien në fuqi të vendimit nr. 266, datë 21.12.2018, të Bordit të ERE, në lidhje me tarifën e shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike për vitin 2021” është 0.75 lekë/kWh.
- **Tarifa e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes në nivelin e tensionit 35 kV:** bazuar në Vendimin Nr. 213, Datë 15.12.2020, të bordit të ERE, “Mbi shtyrjen e fuqisë juridike të vendimit të ERE nr. 199, datë 12.12.2019, për tarifën e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes sipas nivelit të tensionit për vitin 2021” është 1.5 lekë/kWh.
- **Çmimi vjetor i blerjes së energjisë elektrike që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi për vitin 2021 është 7.448 lekë/Kwh:** bazuar në vendimin Nr.16, datë 20.01.2021.

- Në zbatim të *Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit*, të rishikuar, llogaritjet e FSHU sh.a., si dhe përlllogaritjet e ERE-s për përcaktimin e çmimit për klientët që furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, për muajin Gusht 2021, paraqiten në tabelën përmbledhëse si vijon:

Çmimi i FMF-së për muajin Gusht 2021

Gusht 2021			Aplikimi FSHU sh.a.	Përlllogaritjet e ERE
		Njësia	Çmimi	Çmimi
CBEt	Çmimi mesatar i ponderuar i blerjes në treg të parregulluar ose blerja nga prodhuesit me përparësi	Leke/kWh	10.667	10.667
Pr	<u>Kthimi për riskun i përcaktuar në përqindje për vitin (3%)</u>	<u>Leke/kWh</u>	<u>0.19</u>	<u>0.32</u>
	Çmimi mesatar i blerjes në periudhën relevante	Leke/kWh	10.86	10.99
CA	Kosto administrative të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit	Leke/kWh	1.79	1.79
TRr	Tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit	Leke/kWh	0.75	0.75
TSHt	Tarifa e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes	Leke/kWh	1.50	1.50
<b>Çmimi i energjisë = CBEt + Pr* CBEt+ TRrTSHt+CA</b>		<b>Leke/kWh</b>	<b>15.03</b>	<b>15.03</b>

- Për sa përcaktuar për çdo element të formulës përlllogaritëse, bazuar në informacionet e paraqitura në këtë aplikim, informacionet e procedurës së blerjes së energjisë nga shoqëria Furnizuesi i Tregut të Lirë (FTL sh.a.) si dhe vlerësimeve të ERE-s sa më sipër, rezulton se çmimi i shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin **Gusht 2021, të jetë 15.03 Lekë/kWh.**

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

#### Vendosi:

- Miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit prej 15.03 Lekë/kWh për muajin Gusht 2021.
- Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankimi në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Petrit AHMETI**